



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 350/2 Prot

Tiranë, më 17/03/2025

Lënda : Dërgohet Raport monitorimi i Zbatimit të Planit të Integritetit për vitin 2024 i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

KOORDINATORIT TË INTEGRITETIT
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

TIRANË

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 1506/1 prot, datë 03.03.2025, “Mbi zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2024”, ju dërgojmë bashkëlidhur Raport Monitorimin e Zbatimit të Planit të Integritetit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për vitin 2024. Personi përgjegjës për zbatimin e Planit të Integritetit është znj. Nertila Goga, Specialist i Financës, Buxhetit dhe Burimeve Njerëzore me nr. Tel. 0688417869; email: Nertila.Goga@ga.gov.al.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë një kopje të dokumentacionit të sipërcituar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Adrian Bylyku

Konceptoi: N. Goga
Pranoi D.Balla
Miratoi: N. Goga

Specialist i Burimeve Njerëzore
Përgj. Sek të Financës, Buxhetit dhe Burimeve Njerëzore
Dr e Finances dhe Shërbimeve Mbështetëse





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR



RAPORT MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË
INTEGRITETIT TË SHËRBIMIT GJEOLGJIK
SHQIPTAR PËR VITIN 2024

Pasqyra e programit

I - Përmbledhje Ekzekutive.....	3
II - Masat dhe aktivitetet e parashikuara për zbatim për të vitin 2024 dhe niveli i realizimit për secilin objektiv si më poshtë:	3
III - Analizë sasiore dhe cilësore e të dhënave të raportuara	5
IV- Konkluzione dhe Rekomandime.....	6

I - Përmbledhje Ekzekutive

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në ndërgjegjësim të sfidave dhe qasjeve kundër korrupsionit ka miratuar Planin e Integritetit 2023-2027.

Ky Plan Integriteti synon përmirësime dhe përditësime të rëndësishme dhe sistematikë në disa fusha dhe drejtime të veprimtarisë së SHGJSH si:

- Përmirësimi i standarteve të aksesit të informacionit, duke synuar rritjen e transparencës;
- Përmirësimin dhe përditësimin e akteve ligjore dhe nënligjore, duke vënë theksin tek integriteti dhe etika institucionale;
- Forcimin e mekanizmave institucional të pjesëmarrjes qytetare, duke krijuar aksesueshmëri të publikut në vendimmarrjen institucionale;
- Përmirësimin dhe përditësimin e mekanizmave, planifikues, monitorues dhe të kontrollit të brendshëm, për menaxhim me efikasitet të fondeve publike.

Plani i Integritetit parashikon 25 masa të karakterit operacional, rrugullator, kontraktual, ligjor, disa prej të cilave janë parashikuar për tu përmbushur në disa aktivitete të njëpasnjëshme, fushat e përgjegjësisë së SHGJSH si:

1. Përmirësimi i mekanizmave të etikës dhe integritetit;
2. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore;
3. Rritja e transparencës;
4. Përmirësimi i Menaxhimit Financiar.
5. Përmirësimin e drejtimit të politikave për të promovuar integritetin dhe parandaluar korrupsionin.

Këto masa (aktivitete) janë parashikuar për tu realizuar për periudhën 2023-2027 dhe kërkon angazhimin dhe veprimtarinë e titullarit të institucionit, dhe drejtorive të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

II - Masat dhe aktivitetet e parashikuara për zbatim për të vitin 2024 dhe niveli i realizimit për secilin objektiv si më poshtë:

Objektivi 1. Përmirësimi i mekanizmave të etikës dhe integritetit

Objektivi 1	Masat dhe Aktivitetet gjithsej	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të përealizuara
Përmirësimi i mekanizmave të etikës dhe integritetit	5	5	5	0	0

Ky objektiv parashikon gjithsej, 5 (pesë) masa (aktivitete) për vitin 2024 dhe në vazhdim dhe janë masa që parashikojnë kryesisht trajnime, për të cilat strukturat përgjegjëse raportojnë se janë në proces koordinimi me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) me qëllim kryerjen e tyre sipas nevojave. Këto masa, nuk kanë parashikuar buxhet nga buxheti i institucionit, pasi do të kryhen nga ASPA, si dhe janë masa që pritet të japin rezultat në vijim të punës

Objektivi 2. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore

Objektivi 2	Masat dhe Aktivitetet gjithsej	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të përfunduar
Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore	4	4	4	0	0

Masat (aktivitetet) të objektivit 4 (katër) të parashikuara për vitin 2024 e në vazhdim, janë kryesisht janë masa teknike, për të cilat strukturat përkatëse raportojnë si të realizuara kërkesat kryesisht lidhur me plotësimin e strukturave dhe me trajtimin e ankesave administrative. Masa që kanë ndikuar në mbarëvajtjen e punës së Sektorit/Drejtorisë përkatëse dhe institucionit në përgjithësi. Gjithashtu, janë raportuar si në proces kryesisht masat për trajnimin e nëpunësve që është një proces dinamik dhe i vazhdueshëm dhe kërkon në çdo kohë koordinim me ASPA.

Objektivi 3. Rritja e transparencës

Objektivi 3	Masat dhe Aktivitetet gjithsej	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të përfunduar
Rritja e transparencës	1	1	1	0	0

Për këtë objektiv janë 4 (katër) masat parashikuar për vitin 2024 e në vazhdim dhe raportohet se masat janë përmbushur.

Objektivi 4. Përmirësimi i Menaxhimit Financiar.

Objektivi 4		Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve
-------------	--	-------------------------------------

	Masat dhe Aktivitetet gjithsej	Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të përfunduara
Përmirësimi i Menaxhimit Financiar	14	14	14	0	0

Ky objektivi ka të parashikuar pjesën më të madhe të masave (aktiviteteve) që u parashikuar në realizohen për të vitin 2024 e në vazhdim, për përmirësimin e menaxhimit financiar. Janë ndërmarrë dhe realizuar 14 (katërbëdhjetë) masa dhe aktivitete.

Objektivi 5. Përmirësimi i drejtimeve për të promovuar integritetin dhe parandaluar korrupsionin

Objektivi 5	Masat dhe Aktivitetet gjithsej	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të përfunduara
Përmirësimi i drejtimeve dhe për të promovuar integritetin dhe parandaluar korrupsionin në fushat e përgjegjësisë së SHGJSH	1	1	1	0	0

Për këtë objektivi është parashikuar dhe ndërmarrë 1 masë për vitin 2024, dhe raportohet masa është përmbushur.

Sutrukturat përgjegjëse për përmbushjen e këtyre masave janë të gjitha Drejtoritë e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Masat ishin kryesisht të karakterit operacional, ligjor, rregullator dhe kontraktual.

III - Analizë sasiore dhe cilësore e të dhënave të raportuara

Për vitin 2024 sipas planit të veprimit janë 25 masa dhe (aktivitete) për tu përmbushur gjatë vitit 2024, ku shkalla e realizueshmërisë së tyre është si më poshtë:

- 25 (njëzet e pesë) janë realizuar plotësisht masat mbi korrupsionin në fushat e përgjegjësisë së SHGJSH-së

Nga masat e parashikuara për vitin 2024 janë 23 (njëzet e tre) masa me risk të ulët dhe 2 (dy) me risk të mesëm.

IV- Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të planit të integritetit dhe hartimit të raportit të monitorimit. Gjatë vitit 2024 ka pasur një numër të konsiderueshëm masash që janë parashikuar për tu përmbushur dhe ka angazhuar një numër të konsiderueshëm subjektsh përgjegjëse.

Në analizë të monitorimit për këtë periudhë, të gjetjeve dhe dokumenteve, të dhënave analitike që subjektet/drejtoritë kanë raportuar, rezulton se:

- ✓ Strukturat e SHGJSH-së janë angazhuar në zbatimin në vijimësi të Planit të Integritetit, por për disa struktura duhet angazhim me i plotë;
- ✓ Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe përfshirjen në trajnime janë ndërmarrë hapa konkret për përmirësimin e këtyre masave në bashkëpunim me ASPA;
- ✓ Janë ndërmarrë hapa konkret në transparencën dhe publikimin e akteve/manualeve, raporteve të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të institucionit për çdo subjekt të interesuar.

Rekomandohet.

- ✓ Rekomandohet vijimi i zbatimit të planit të masave sipas afateve të përcaktuara;
- ✓ Të rishikohet plani i masave në përshtatje me ndryshimet ligjore dhe nëligjore dhe më fushën e përgjegjësisë së Ministrisë
- ✓ Të vijojë bashkëpunimi mes strukturave përgjegjëse për përmbushjen e masave, si dhe me institucionet që duhet të bashkërendojnë, koordinojnë procesin;
- ✓ Të vijohet me ngritjen e grupeve të posaçme të punës, dhe koordinimit më qëllim shfrytëzimin e të gjithë afateve kohore të përcaktuara për përmbushjen e masave.

Hartoi: Nertila Goga

(Person Përgjegjës për ndjekjen e procesit të zbatimit të Planit të Integritetit)